

Vendim nr. 117 datë 31.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 31.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ANDRI LEKA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 398 (13-2022-2767), datë 24.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2022-1023 (216), datë 14.06.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1218, datë 06.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 2 dhe 71/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit E.K., Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 217/2021 në ngarkim të shtetasit Andri Leka (*kërkuesi*), shtetases V.S., me funksion Komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe dy subjekteve të tjera. Më pas E.K. ka depozituar në Prokurorinë e Posaçme edhe materiale të tjera, në shtesë dhe plotësim të kallëzimit nr. 217/2021.

2. Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për subjektin e posaçëm V.S., ndërkohë që me shkresën nr. 606 prot., datë 30.07.2021, ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë materialin kallëzues nr. 217/2021 në ngarkim të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Shtrengimi me anë të kanosjes për dhënie pasurie”, të parashikuar nga neni 109/b, paragrafi i parë, të lidhur me nenin 25 të Kodit Penal (*KP*), si dhe “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a, paragrafi i parë, i *KP*-së, i cili është regjistruar nga kjo prokurori si procedimi penal nr. 5649/1 i vitit 2021. Gjatë kësaj kohe kërkuesi ndodhej në paraburgim, për shkak të arrestimit në flagrancë, si rrjedhojë e kanosjes së shtetases A.K., motra e shtetasit E.K., me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Në datën 09.08.2021 shtetasja B.K., bashkëshorte e shtetasit E.K., me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka depozituar kallëzim penal ndaj kërkuesit. Ky material kallëzues është bashkuar me aktet e përcjella nga Prokuroria e Posaçme, pasi përmbajtja e tyre ka qenë e njëjtë.

4. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dalë në përfundimin se ka dyshime të bazuara në prova, se kërkuesi, nëpërmjet shtrengimit me dhunë dhe kanosjes, ka cenuar shtetasit E.K., A.K. dhe B.K., me qëllim që ata ose familjarët e tyre, të kryejnë ose të mos kryejnë veprime të caktuara, si dhe anëtarë të sistemit gjyqësor, që vijnë në dijeni të ngjarjeve, të ndikohen për të kryer ose moskryer veprime të caktuara. Hetimi ka vazhduar më tej edhe për procedimin penal nr. 5649/2021 të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetases B.K. dhe prokuroria ka vlerësuar se hetimet janë të plota dhe ndaj kërkuesit është ngritur akuzë, sipas neneve 121/a, paragrafi i parë dhe 109/b, paragrafi i parë, të *KP*-së.

5. Në lidhje me kallëzimin e shtetases A.K., dosja penale është ndarë nga ajo me të dëmtuar shtetasin E.K., duke u numërtuar si dosja penale nr. 5649/2 e vitit 2021. Në lidhje me këtë procedim penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 78 të Kodit të

Procedurës Penale (KPP), ka disponuar se çështja duhet t'i kalojë për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me arsyetimin se e dëmtuara A.K. ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në lidhje me faktin e kallëzuar nga shtetasi E.K., hetimet kanë vijuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Në vijim, në lidhje me procedimin penal nr.5649/1/2021 të të dëmtuarit E.K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 184/1, datë 26.01.2022, ka vendosur masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, ndërsa me vendimin nr. 184/3, datë 24.02.2022, ka disponuar për vazhdimin e masës së sigurimit, si dhe ka vendosur shpalljen e moskompetencës së saj dhe kalimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si gjykata më e afërt ku nuk ka punuar i dëmtuari nga vepra penale, i cili ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Në zbatim të nenit 88 të KPP-së, me vendimin nr. 217, datë 04.04.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së ndaj kërkuesit. Nisur nga fakti që aktet e këtij procedimit penal kishin lidhje, për shkak të kërkuesit, me hetimin që ndërkohë kishte kaluar më parë për kompetencë lëndore e tokësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (procedimi nr. 5649/2/2021 lidhur me faktin e kallëzuar nga shtetasja A.K.), Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka disponuar për kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si organi kompetent lidhur edhe me këtë procedim penal.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në referencë të nenit 88 të KPP-së, me vendimin nr. 13-2022-2767(398), datë 24.05.2022, ka vendosur rivlerësimin e zbatimit të masës së sigurimit personal të dhënë me vendimin penal të datës 04.04.2022 për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b, paragrafi i parë, 25 dhe 121/a, paragrafi i parë, të KP-së. Kjo gjykatë ka arsyetuar se meqenëse aktet e procedimit penal në ngarkim të kërkuesit i kanë kaluar për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kjo e fundit, në cilësinë e gjykatës kompetente lidhur me procedimin penal, ka vlerësuar si të domosdoshme rivlerësimin e vendosjes së masës së sigurimit personal për kërkuesin. Ky vendim është kundërshtuar nga ai nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

9. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-1023(216), datë 14.06.2022, ka vendosur miratimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me arsyetimin se vendimmarrja e asaj gjykate përbën zbatim të drejtë të nenit 88 të KPP-së, pasi në këtë rast nuk ka

dy masa sigurimi personal “Arresti në burg” për të njëjtin fakt, përkundrazi, secila nga gjykatat, ato kompetente dhe jo kompetente, kanë vlerësuar kushtet dhe kriteret e zbatimit dhe të caktimit të masës së sigurimit, duke pasur parasysh natyrën e dy veprave penale, rrethanat konkrete të ngjarjes dhe sjelljen e personit nën hetim kundrejt disa personave. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1218, datë 06.10.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur kundër vendimit nr. 10-2022-1023 (216), datë 14.06.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesi, nuk u referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, si dhe pavarësisht mënyrës së veprimit nga prokuroria dhe/ose gjykatat e faktit, parregullsitë e evidentuara nuk sjellin pasoja në masën e sigurimit “Arrest në burg” të caktuar ndaj të hetuarit.

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 13.04.2023, me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt gjykimi i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

12.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka justifikuar veprimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës edhe pse ka konstatuar moszbatimin e ligjit nga ana e këtij organi procedues. Mosnjoftimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, për shpalljen e moskompetencës pa pasur shkaqe dhe arsye të ligjshme, si dhe vendimet e mëpasshme të dhëna nga gjykatat e tjera, i kanë cenuar kërkuesit të drejtën për akses në gjykatë, duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të pasur kohën e duhur për të përgatitur mbrojtjen e tij, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kryer një hetim të përciptë lidhur me veprimet procedurale të dosjes hetimore të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i marrë të mirëqena veprimet procedurale të kësaj prokurorie për shpalljen e moskompetencës.

12.2. Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, në dy drejtime:

12.2.1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gabuar në vendim për përcaktimin e bazës ligjore.

Për dublimin e masës së sigurimit personal të kërkuesit dhe mosnjohimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shpalljen e moskompetencës nga ana e Prokurorisë pranë kësaj gjykate, ky kolegji i është referuar nenit 79 të KPP-së, ndërkohë që thelbi i konfliktit ligjor konsiston në parashikimet e neneve 84, pika 2 dhe 88 të po këtij kodi. Gjykata e Lartë është kufizuar vetëm në evidentimin nëse ka pasur ose jo pasoja në masën e sigurimit personal të kërkuesit. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka gabuar në përcaktimin e bazës ligjore për dhënien e vendimit, fakt ky i konstatuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

12.2.2. Gjykata e Lartë dhe gjykata e apelit nuk kanë konstatuar se vendosja e një mase tjetër sigurimi ndaj kërkuesit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, edhe pse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e kishte vendosur dhe miratuar paraprakisht këtë masë sigurimi personal, bie ndesh me parashikimet e nenit 88 të KPP-së. Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar se këto veprime kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta për kërkuesin, si dhe nuk i ka dhënë zgjidhje çështjes se dy gjykatat, në një kohë tepër të shkurtër, kanë dubluar masat e sigurimit personal, pasi për të njëjtën çështje kanë rënduar atë proceduralisht, duke aplikuar masën ekstreme “Arresti në burg”, të pakërkuar nga organi i akuzës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nismën e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e

veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

15. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Detyrimi për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me këto të fundit, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim

përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në gjykatë procedurat gjyqësore për rivlerësimin e zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, si dhe mosnjohimin nga prokuroria për shpalljen e moskompetencës, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1218, datë 06.10.2022 e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Procedurat e këtij lloji, për nga natyra e tyre, janë të tilla që i nënshtrohen juridiksionit kushtetues, për rrjedhojë kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese që pretendon se i janë shkelur.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 06.10.2022 dhe i është komunikuar në rrugë elektronike përfaqësuesit ligjor të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në datën 13.12.2022. Ankimi kushtetues individual fillimisht është paraqitur në Gjykatë në datën 11.04.2023 dhe pas plotësimit të tij është regjistruar në datën 13.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në drejtim të standardit të arsyetimit kërkuesi ka argumentuar se dublimi i masave të sigurimit personal ka të bëjë me faktin se masa e sigurimit “Arresti në burg”, e vendosur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka krijuar mbivendosje me atë të vendosur paraprakisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rënduar pozitën procedurale të kërkuesit si person nën hetim.

20. Nisur nga këto pretendime të kërkuesit, duke qenë se masat e sigurimit personal ndikojnë në lirinë personale të individit, Kolegji çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit liria nuk mund të cenohet pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e lirive kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se edhe pse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk është pjesë e objektit të këtij ankimi kushtetues individual, ai do të analizohet për shkak se është dhënë nga gjykata brenda të njëjtit proces penal, ku janë marrë vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit, të cilat kundërshtohen nga kërkuesi.

21. Ndërsa për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, kërkuesi ka argumentuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vepruar në shkelje të nenit 84, pika 2, të KPP-së dhe Gjykata e Lartë e ka justifikuar veprimin e saj, edhe pse ka konstatuar moszbatimin e ligjit nga ana e këtij organi procedues. Duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi e ka bazuar këtë pretendim në argumentet e dhëna nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen e çështjes, e cila, sipas tij, nuk ka konstatuar shkeljet e prokurorisë dhe të gjykatave të zakonshme, ai do të analizohet në këndvështrim të procesit të rregullt ligjor së bashku me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

22. Për rrjedhojë, në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, pretendimet e kërkuesit do të shqyrtohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

23. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se mosnjohimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, për shpalljen e moskompetencës pa pasur shkaqe dhe arsye të ligjshme, si dhe vendimet e mëpasshme të dhëna nga gjykatat e tjera, i kanë cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të pasur kohën e duhur për të përgatitur mbrojtjen e tij, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka gabuar për përcaktimin e bazës ligjore. Thelbi i konfliktit ligjor lidhur me dublimin e masës së sigurimit të tij personal dhe mosnjohimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shpalljen e moskompetencës nga ana e Prokurorisë pranë kësaj gjykate, konsiston në parashikimet e neneve 84, pika 2 dhe 88 të KPP-së, ndërkohë që Gjykata e Lartë i është referuar nenit 79 të po këtij kodi. Ajo nuk është kujdesur për të analizuar procedurën e ndjekur për garantimin e procesit të rregullt ligjor ndaj kërkuesit, por është kufizuar vetëm në evidentimin e faktit nëse ka pasur ose jo pasoja në masën e sigurimit personal të kërkuesit.

24. Sipas kërkuesit edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kryer një hetim të përciptë lidhur me veprimet procedurale të dosjes hetimore të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i marrë të mirëqena veprimet procedurale të kësaj prokurorie në lidhje me shpalljen e moskompetencës. Ajo ka gabuar në përcaktimin e bazës ligjore për dhënien

e vendimit, fakt ky i konstatuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë dhe gjykata e apelit nuk kanë konstatuar se vendosja e një mase tjetër sigurimi ndaj kërkuarit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, edhe pse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e kishte vendosur dhe miratuar paraprakisht këtë masë sigurimi personal, bie ndesh me parashikimet e nenit 88 të KPP-së.

25. Gjykata, lidhur me të drejtën e aksesit, ka theksuar se ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 184/1, datë 26.01.2022, ka vendosur masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit për procedimin penal 5649/1/2021. Me vendimin nr. 184/3, datë 24.02.2022, kjo gjykatë ka disponuar për vazhdimin e masës së sigurimit. Me vendimin nr. 217, datë 04.04.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në cilësinë e gjykatës kompetente, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Në këto kushte, në lidhje me masën e marrë nga kjo e fundit, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka qenë paraprakisht në gjendje të lirë ose nën një masë tjetër më të lehtë sigurimi personal dhe pozita e tij nuk është rënduar nga dhënia e së njëjtës masë sigurimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, dhënë nga kjo gjykatë, është vazhdim i së njëjtës masë sigurimi personal të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në rastin konkret nuk ka mbivendosje ose dublim të masave të sigurimit personal të kërkuesit, të cilat të kenë ndikuar në lirinë e tij personale.

29. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 13-2022-2767 (398), datë 24.05.2022, ka vendosur rivlerësimin e zbatimit të masës së sigurimit personal për kërkuesin, e cila është miratuar nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-1023 (216), datë 14.06.2022. Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka qenë e legjitimuar për të verifikuar kryesisht nevojat e sigurimit të kësaj mase në bazë të nenit 246, pika 6, të KPP-së, fakt ky që nuk ka sjellë ndonjë pasojë në përkeqësimin e pozitës procedurale të të hetuarit.

30. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kryer një hetim të përciptë lidhur me veprimet procedurale të dosjes hetimore të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i marrë të mirëqena veprimet procedurale të kësaj prokurorie për shpalljen e moskompetencës, në ndryshim nga sa parashtrohet kërkuesi, Kolegji vëren se nga ecuria e procesit gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pas marrjes së akteve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka proceduar me kryerjen e verifikimit të masës së sigurimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

31. Për sa i takon mosnjoftimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shpalljen e moskompetencës nga ana e Prokurorisë pranë kësaj gjykate, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se neni 84 i KPP-së, i cili rregullon veprimtarinë e organit procedues, në rast të shpalljes së moskompetencës në fazën e hetimeve paraprake, ndonëse parashikon detyrimin e prokurorit që kur shpall moskompetencën e tij për çdo lloj shkak, duhet të njoftojë të dyja gjykatat, nuk

parashikon ndonjë pasojë procedurale në rastin kur ky njoftim nuk realizohet. Kjo dispozitë nuk parashikon as ndonjë pasojë për procedimin në rastin kur prokuroria nuk njofton të hetuarin për këtë vendim. Në rastin konkret, ky kolegji ka përdorur vendimin njehsues nr. 00-2020-1120 (55), datë 13.10.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit nuk rrjedh asnjë pasojë për masën e sigurimit të caktuar, në rastin kur disponohet për kalimin e akteve, gjatë hetimeve paraprake, nga një prokurori tek tjetra, e motivuar me konstatimin e moskompetencës për të hetuar, duke qenë se bëhet fjalë për akte të nxjerra nga një organ/prokurori, i konsideruar palë (megjithëse palë publike në proces (procedim), pa pushtet dhe kompetenca të karakterit juridiksional (*shih paragrafin 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi kundërshtimet e tij për këto parregullsi të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatën e Apelit Durrës, ku përfaqësuesi i tij ligjor është njoftuar, ka marrë pjesë në seancë gjyqësore dhe ka parashtruar kundërshtimet përkatëse. Të dyja gjykatat e sipërcituara i kanë shqyrtuar pretendimet e tij dhe janë shprehur me vendime gjyqësore. Si rrjedhim, pavarësisht gjykatës që ka shqyrtuar pretendimet, kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë. Në këtë kontekst, çmohet se pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

33. Gjithashtu, Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk është shprehur me vendim për shpalljen e moskompetencës, për rrjedhojë, në këtë rast, nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 88 të KPP-së, por situata në fjalë rregullohet me vendimin njësues nr. 00-2020-1120 (55), datë 13.10.2021 të Kolegjit Penal të kësaj gjykate. Pavarësisht kësaj, në vlerësimin e Kolegjit Penal, kjo pasaktësi nuk ka sjellë asnjë pasojë në llojin e masës së sigurimit të caktuar, aq më pak shuarjen ose humbjen e efekteve të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Për sa i përket zbatimit të nenit 79 të KPP-së, ky Kolegji ka arsyetuar gjithashtu, se vlerësohet se janë kushtet ligjore për zbatimin e nenit 79 të KPP-së, për bashkimin e procedimeve penale që u përkasin fakteve të kallëzuara nga shtetasit A. K. dhe E. K., pasi në të dyja rastet akuzohet i njëjti person/i hetuari Andri Leka (*shih paragrafët 22-24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

34. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në asnjë rast në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk është konfunduar situata e zbatimit të nenit 88 të KPP-së me atë të zbatimit të nenit 79 të po këtij kodi. Në arsyetimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është argumentuar qartë lidhur me

momentin e moszbatimit të nenit 88 të KPP-së dhe aplikimit të jurisprudencës së kësaj gjykate, ndërkohë që neni 79 i KPP-së është përmendur me qëllim bashkimin e procedimeve penale që u përkasin fakteve të kallëzuara nga shtetasit A. K. dhe E. K., pasi në të dyja rastet akuzohet i njëjti person. Si rrjedhim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gabuar për përcaktimin e bazës ligjore, është haptazi i pabazuar.

35. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se në vështrim të standardeve kushtetuese, jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, referimi ligjor i bërë në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka passjellë cenim të një të drejte thelbësore për kërkuarin, pasi në çdo rast kjo gjykatë ka qenë e legjitimuar për të vepruar në bazë të nenit 246, pika 6, të KPP-së, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

36. Bazuar në analizën e mësipërme, Kolegji vlerëson se në përputhje me standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, vendimet objekt gjykimi paraqiten të rregullta në formë, koherente dhe nuk rezultojnë të kenë paqartësi ose kundërthënie në përmbajtje. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit, si dhe ka analizuar dhe vlerësuar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta në raport me shkaqet e paraqitura në rekurs, faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, në përmbushje të funksionit të saj për të kontrolluar vendimmarrjen e tyre. Në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë paraqitet vlerësimi se shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuari nuk parashikohen nga neni 432 i KPP-së, të tilla që të vënë në lëvizje gjykimin në Gjykatën e Lartë, duke përkujtuar se në rekurs nuk ngrihen problematika për zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykatat më të ulëta, me rëndësi themelore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, vendimi i rekursuar nuk bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe në rekurs nuk parashtrohet asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

37. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.